

CĂTĂLINA VĂTĂŞESCU\*

**PËRKIME LEKSIKORE DHE KUPTIMORE  
MIDIS RUMANISHTES DHE SHQIPES  
(Festa e Shën Martinit)**

Krishtërimi popullor ndër shqiptarët dhe rumunët po pret akoma hulumtime krahasuese sistematike. Një anë që meriton vëmendje ka të bëjë me vendin e shenjtëve në kulturën popullore të dy popujve, në kalendarin e tyre folklorik. Marrim si shembull rolin e mbrojtësit të ujkut që e ka *Shën Martini - Sân (Sfânt(ul))*<sup>1</sup> *Martin, Martini(i)*. Shqiptarët festojnë Shën Martinin më 11 dhe 12 nëntor. Rumunët e kremtojnë jo vetëm më 12-14 nëntor (*Martinii de Toamnă* “Martinët e vjeshtës”), por edhe në shkurt (më 1-3, *Martinii de Iarnă* “Martinët e dimrit”) dhe në verë (22 gusht *Martinul* “Martini”)<sup>2</sup>. Tek rumunët, jo vetëm *Sfântul Martin* (ose *Martinul*), por edhe *Sfântul Filip*, me të cilin është afër në kalendar, del si mbrojtës i ujkut; besimet lidhur me të dy shenjtërit janë të njëjta dhe të ngjashme me ato të shqiptarëve lidhur me Shën Martinin<sup>3</sup>. Në çerekun e fundit të shekullit XIX, B.P. Hasdeu u ka dërguar mësuesve të fshatrave një pyetësor të pasur, me 206 pyetje (*Chestionarul Hasdeu*) me qëllim të njohë visarin gjuhësor dhe besimet dhe doket e popullit dhe të hartojë një fjalor sa më të plotë të gjuhës rumune<sup>4</sup>. Nga përgjigjet e dhëna për pyetjen mbi bishat, ndër të cilat edhe ujku (nr. 78), shihet se ushqimin e ujqve mund ta

\* Instituti i Studimeve për Evropën Juglindore të Akademisë Rumune.

<sup>1</sup> Siç dihet, trajta e vjetër *sân(t)*, që bashkë me alb. *shën* vjen nga lat. *sanctus*, ka qenë zëvendësuar me trajtën *sfânt*, e ndikuar nga sllavishtja.

<sup>2</sup> Ion Ghinoiu, *Sărbători și obiceiuri românești*, Editura Elion, București, 2003, p. 87, 88, 94, 95, 281, 365. Festa më e kremtuar është më 2 shkurt.

<sup>3</sup> Në besimet e barinjve rumunë edhe shenjtërit të tjerë ishin mbrojtës të ujqve: Shën Pjetri (Sfântul Petru), Shën Todhri (Sfântul Teodor) ose Shën Ndreu (Sfântul Andrei). Nga ana tjetër, *Sfântul Martin* mbron jo vetëm ujqit, por edhe arinjtë (Ion Ghinoiu, *Sărbători și obiceiuri românești*; idem, *Mitologie română. Dicționar*, Univers enciclopedic. Gold, București, 2013).

<sup>4</sup> Ai vetë ka botuar vetëm shkronjën A dhe fillimin e shkronjës B të fjalorit. Fletoret me përgjigjet që mori ruhen në dorëshkrim në Bibliotekën e Akademisë Rumune dhe u shfrytëzuan pastaj në *Fjalorin e Gjuhës Rumune të Akademisë*. Pjesa folklorike dhe etnografike u botua në mënyrë të përmbledhur në vëllimin *Tipologia folclorului din răspunsurile la chestionarele B.P. Hasdeu*, nga Ion Mușlea, Ovidiu Bîrlea, hyrje nga Ion Taloș, botim i dytë rishikuar dhe plotësuar nga Ioan I. Mușlea, Editura Academiei, București, 2010.

sigurojnë Shën Pjetri, Shën Ndreu, por edhe Perëndia vetë<sup>5</sup>. Është për të vërejtur, së paku në një vështrim të parë, se besimet lidhur me ujqit dalin vetëm në vendet malore, kodrinore, ku ka jetë baritore të zhvilluar, e jo edhe në fshatrat në zonat fushore. Gjithashtu, për pyetjen që ka të bëjë me shenjtërit (nr. 170) ka përgjigje të përshtatshme vetëm në zonat me jetë baritore<sup>6</sup>. Një kërkim i plotë që të krahasojë situatën ndër rumunët dhe ndër shqiptarët lidhur me zonat ku ekziston nderimi i shenjtëve që sundojnë ujqit dhe mbrojnë njerëzit nga ujqit është i nevojshëm.

Po përmendim një përshkrim të mënyrës se si i kremtojnë shqiptarët ditët e Shën Martinit dhe çfarë besimesh janë lidhur me të në veriun e vendit<sup>7</sup>. Gratë nuk punojnë, sidomos leshin, nuk lënurin, nuk presin petka të leshta me gërshanë. Këto porosi ndaluese dhe gjeste me vlerë simbolike (gërshana simbolizon, me sa duket, gojën e bishës që nuk duhet të hapet që të mos të hajë kafsha) kanë rolin ta mbrojnë bagëtinë nga bishat pylli, sidomos nga ujku. Në mënyrë të ngjashme, gratë rumune nuk qepin, nuk tjerrin, nuk thurin, nuk përdorin asnjë vegël të mprehtë nga frika se ujqit mund t'i marrin të gjitha delet ose dhitë<sup>8</sup>. Siç shihet, dhe ndër shqiptarët dhe ndër rumunët në ruajtjen e këtyre kremteve gratë kanë një rol kryesor<sup>9</sup>.

Fakti me rëndësi është, pra, se edhe ndër shqiptarët edhe ndër rumunët Shën Martini është përfytyruar duke pasur pushtet mbi ujq. Në traditat e dy popujve, ai u jep ushqim ujqve dhe ujku që mbetet pa ushqim ka lejë t'u bjerë kopeve të deleve ose të dhive. Ujku, të cilit i thonë *Goj-lidhmi* (Goj'e lidhur), shenjt i çel gojën, sepse, ndryshe ai vetë nuk ka mundësi të hajë asnjë kafshë nëse i bie ndonjë tufe. Midis gjesteve rituale të bëra gjatë ditëve të Shën Filipit/Shën Martinit, rumunët kanë edhe atë të shtrëngimit të dy krehërave për të lënurur leshin duke thënë *Aşa să se încleșteze gura lupilor, să nu poată mânca vita cutare* "Kështu të shtrëngohet goja e ujqve të mos hajë atë gjë"<sup>10</sup>. Sipas një tjetër besimi popullor thuhet rumanisht se "ujqit kanë gojën

<sup>5</sup> *Tipologia*, p. 265-266; 372-374; 376.

<sup>6</sup> Është rasti, për shembull, i një zone fushore pranë Tunës, Brăila, ku asnjë përgjigje nuk përmend zakonet lidhur me shenjtërit mbrojtës të ujqve; përveç kësaj, shenjtërit Martin dhe Filip as nuk gjinden ndër shenjtërit e përmendur (*Documente privind istoria Brăilei. Răspunsurile la Chestionarele Odobescu și Hasdeu pentru județul Brăila*. Botim nga Ionel Cădea dhe Costin Croitoru, Muzeul Brăilei "Carol I", Editura Istros, 2015).

<sup>7</sup> *Shën Mërtit*, në *Folklorë. Përmbledhje vrojtimesh permbi zakonet edhe gjühen popullore të botueme në revisten "Leka" nder 11 vjetet e para*. I. Zakone e doke, Shtypshkroja "Zoja e Paperlyeme", Shkoder, 1940, p. 60-61.

<sup>8</sup> *Tipologia*, p. 373. Marcel Lapteş, *Anotimpuri magico-religioase. Schițe etnografice*, Editura Corvin, Deva, 2011, p. 232.

<sup>9</sup> Për rumunët shiko *Tipologia*, p. 372.

<sup>10</sup> Antoaneta Olteanu, *Calendarele poporului român*, Editura Paideia, București, 2001, Marcel Lapteş, p. 256, *Tipologia*, p. 373.

shtrënguar fort kur kanë dasmë, kur është koha e ndërimit” (*lupii au gura încleștată când au nuntă*) dhe atëherë nuk mund të bien në një kope. Afër shprehjes shqipe është edhe togfjalëshi *legatul lupilor* “lidhja e ujqve”<sup>11</sup>.

Lidhja midis Shën Martinit dhe ujkut në legjendat mitike shqiptare është vënë në dukje hollësisht nga Mark Tirta<sup>12</sup>. Ujqit janë nën mbrojtjen e shenjtit që i ushqen me kokrra ose u cakton kafshët shtëpiake që kanë për të ngrënë<sup>13</sup>, ose ujku *e ka gojën e drynueme* sepse *ia ka drynue i Shmërtini*<sup>14</sup>. M. Tirta tregon, mjerisht pa hollësira, se njerëzit besojnë se ujku ha vetëm gjënë e vet, që ia lejon shenjti, dhe se kur bie ndër berre, ato më vonë do të kenë mbarësi<sup>15</sup>. Në juglindjen e Transilvanisë (Tara Hațegului) bariu jepte një qengj për mëshirë, duke thënë se i takon ujkut që të mos i bjerë tufës<sup>16</sup>. Përgjigjet që merr Hasdeu përmbajnë mjaft situata të ngjashme, që duhen përmendur edhe pse nuk është fjala për Shën Martinin por për Perëndinë: kur ulërin, ujku i lutet Perëndisë që të hajë diçka, Perëndia i cakton kafshën ose e dërgon ta hajë, Perëndia i jep ujkut kokrra për ta ngopur në mënyrë që të mos hajë dele ose dhi; është dhënë nga Perëndia që ujku të hajë njeriun; është një shenjë mbarësie kur ujku merr diçka nga tufa, ose kur dikush e takon në rrugë<sup>17</sup>.

Kuptimi dhe rëndësia që ka përdorimi i ngjyrës së gjelbër në paraqitjet e besimeve në fjalë duhen hulumtuar. Sipas M. Tirtës, në legjendat mitike ujqit janë nën mbrojtjen e Shën Martinit që i ushqen me disa kokrra *të jeshilta*. Shën Martini (ose Shën Mërtiri në toskërisht) del në disa variante si gjigand të veshur me *rroba të gjelbërta*<sup>18</sup>. Në rumanisht fjala *verde* “jeshil, gjelbër”

<sup>11</sup> Marcel Lapeș, p. 39, 59. Për magjitë e bëra për t'i lidhur gojën ujkut shiko *Tipologia*, p. 265.

<sup>12</sup> Mark Tirta, *Mitologjia ndër shqiptarë*, Tirana, 2004.

<sup>13</sup> M. Tirta, p. 66, 117. Një tregim i tillë mbi shenjtin që drejton ujqit ku të hanë, në *Folklorë*, p. 60.

<sup>14</sup> Shiko më lart alb. *goj'lidhmi*, rum. *gură încleștată*.

<sup>15</sup> Mark Tirta, *Mitologjia*, p. 67.

<sup>16</sup> Marcel Lapeș, *Anotimpuri*, p. 119, 120, 286. Në disa fshatra mali, barinjët therin një dele shterpë dhe e lënë ta hajë ujku (idem, p. 175, 231). Një poet rumun, autor i një cikli me tema marrë nga traditat e fshatit, cikël i ndërtuar si një seri kujtimesh nga fëmijëria, tregon se një zot shtëpie u jep vetë ujqve një dele. Gjesti i tij nuk është kuptuar nga fshati dhe është, ndoshta, një mbeturinë e besimit të vjetër që me sa duket ka kuptim vetëm për atë që e bën. Është vështirë të thuash, duke lexuar poezinë, nëse autori e kujton aktin për çuditërinë e tij ose e di akoma kuptimin magjik; ai përmend shpesh, megjithatë, të kaluarën e largët baritore të fshatit (Marin Sorescu, *La Liliaci, Cartea I* (1973). Kemi përdorur botimin Marin Sorescu, *La Liliaci* (I-III), vol. I, parathënje Ion Pop, Jurnalul Național, Editura Art, București, 2012, p. 129-131).

<sup>17</sup> *Tipologia*, p. 265-266.

<sup>18</sup> Tirta, p. 66, 117.

përdoret në togfjalëshin *joia verde* “e enjte e gjelbër”, i cili emëron ditë të rrezikshme për bagëtitë – si thuhet – ashtu si *Martinii*<sup>19</sup>.

Në traditën baritore shqiptare dhe rumune ujku është një qenie mitike shumë e rëndësishme dhe kujtime për fuqinë e tij ruhen në toponimi. Mark Tirta<sup>20</sup> nxjerr në pah lashtësinë e besimeve duke tërhequr vëmendjen mbi toponimin e vjetër në bregun e Adriatikut *Ulqin* (*Ulkinion*, *Ulcinium*, *Olcinium*). Ky toponim mund të afrohet me trajtën e vjetër të fjalës shqipe: *ulk*. Mundësinë e ruajtjes së toponimisë pararomake pikërisht në kohën e sundimit romak e ka vënë në dukje Emil Lafe<sup>21</sup>. Toponimia rumune e formuar nga “ujk” është e pasur, duke përfshirë trajta të prejardhura nga një anë nga emri rumun dhe nga ana tjetër nga emra sllavë dhe hungarezë (që i përkthejnë): p. sh., *Lupeni*, *Vâlcea*, *Vâlcan*, *Fărcaşele*. Rumanishtja dhe shqipja kanë ruajtur bashkë mjaft shprehje dhe fjalë të urta të lidhura me përvoja të jetës baritore: *lupul îşi schimbă părul dar năravul ba, ujku qimen ndërron, por zakonin s’e harron*<sup>22</sup>.

Sipas mendimit të M. Tirtës, ujku si hyjni bën pjesë në “një shtresë të lashtë paleobalkanike, të ruajtur si mbijetojë e mjegulluar në popuj të ndryshëm”. Tirta flet për kultin e hyjnisë-ujk te Illirët dhe te Trakët, duke cituar Mircea Eliade<sup>23</sup>. Problemi është se si duhet kuptuar të shfaqurit së bashku i hyjnisë trako-ilire dhe i shenjtërve të krishterë. Është vërtet fjala për krishterizimin e një hyjnie të lashtësisë? Pyetja që do t’ishte për të vënë ka të bëjë me kushtet në të cilat ujku u lidh me një shenjt të krishterë dhe u bë, nga një hyjni pagane me fuqi të plotë, një dukuri, të themi, vartëse nga fuqia e shenjtit. Në mentalitetin e krishterimit popullor shqiptar dhe rumun shihet se hyjnia pagane u lë vendin figurave të krishtera. Interes ka edhe fakti se fjala është për po atë shenjt, Martinin. Është për të vërejtur, së dyti, se shqip emri i shenjtit ka artikull proklitik njashu si emrat e farefisniaë. Në fjalët e urta: *Pse s’flet, a ta ka mbyllë gojën i Shën Mërtini?, Ujku i ka drynue [gojën] i Shmërtini*<sup>24</sup>. Në rumanisht, emrat e shenjtërve mund të përdoren pa fjalën *sfânt*, *sân*: *Martinii*, *Martinul*, *Filipii*. Në rumanisht duhet theksuar edhe se shumë festa të krishterë kanë emra në shumës (*Florii*, *Rusalii*, *Sânziene*) dhe në këtë

<sup>19</sup> Ghinoiu, *Sărbători şi obiceiuri*, p. 67, 69, 88.

<sup>20</sup> Tirta, p. 66.

<sup>21</sup> E. Lafe, *Toponime latine-romane në truallin e shqipes*, “Studime filologjike”, XXVII (X) (1973) 3, p. 111-118 (sidomos p. 116).

<sup>22</sup> Për shembuj të tjerë dhe për rëndësinë që ka ujku në traditat e qytetërimit shqiptar dhe rumun shiko Gr. Brâncuş, *Concordanţe lingvistice româno-albaneze*, Bibliotheca Thracologica, XXX, Bucureşti, 1999, p. 110.

<sup>23</sup> Tirta, p. 118, 119, 144. Ai citon Mircea Eliade, *De Zalmoxis à Gengis-Khan. Études comparatives sur les religions et le folklore de la Dacie et de l’Europe Orientale*, Paris, Payot, 1970.

<sup>24</sup> Tirta, p. 66.

seri hyjnë dhe emrat e festave *Martinii*, *Filipii*; emrat e festave në shumës formojnë një dukuri të trashëguar nga latinishtja. Besojmë se gjithë këto tregojnë se është fjala për shenjtër popullorë dhe për shqiptarët dhe për rumunët.

## SUMMARY

### ROMANIAN AND ALBANIAN LEXICAL AND SEMANTIC PARALLELS (ST. MARTIN'S DAY)

The article aims at drawing attention to popular Christianity among Romanians and Albanians, mainly to the role of saints in the popular calendar. Both cultures display traditional faith in the saints protecting against wild beasts (e.g. wolves, bears) within the pastoral environment and in both cultures women play a key role when it comes to preserving this tradition. The article provides a set of similar or identical beliefs in Romanian and Albanian folklore regarding the wolf and certain protecting saints (the same to both peoples), and also highlights lexical similarities in the two languages concerned.

